



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I TITUJVE VENDORË TË NDERIT

V E N D I M

Nr. 6 datë 05/05 2026

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë Përmet

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projekt – vendimit për dhënie titulli “Qytetar Nderi” për Znj. Flora Brovima”.

**Baza ligjore:**

Ligji nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m, Neni 55 e në vijim.

Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

Vendimi Nr.647 datë 31.12.2025 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit,

Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë.

Rregullorja e funksionimit të këshillit bashkiak të bashkisë Përmet.

Komisioni i “Titujve Vendorë të nderit” i mbledhur me datën 05/05 /2026,

shqyrtoi projekt - vendimin e mësipërm dhe dokumentat shoqëruese të paraqitura nga

Organi Ekzekutiv i Bashkisë Përmet, dhe me shumicë votash,

**VENDOSI:**

T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

Kalimin e projekt – vendimit të mësipërm **për shqyrtim, dhe miratimin e tij.**

Bashkëlidhur këtij vendimi është edhe proces-verbali i mbledhjes së Komisionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK

Entela Ibrahimimi – Kryetar

Anida Hajredini – Nënkyetar

Redi Hoxha – Anëtar





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET  
KËSHILLI BASHKIAK



**Proçes-verbali i Mbledhjes së Komisionit të Titujve Vendorë të Nderit**

Data dhe ora e mbledhjes: 05/052026 12:00 deri 13:00

Marrin pjesë :

- Entela Ibrahim** – Kryetar
- Anida Hajredini – Nënkyetar
- Redi Hoxha – Anëtar

Marrin pjesë gjithashtu : (nëse ka të tjerë të pranishëm)

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_

Nga ekzekutivi marrin pjesë :

1. Arjona Papapano
2. \_\_\_\_\_

Projekt-vendim:

Shqyrtimi dhe miratimi i projekt – vendimit për dhënie titulli “Qytetar Nderi” për Znj. Flora Brovima”, propozuar nga Klubi i Shkrimtarëve dhe Artistëve “Naim Frashëri” Përmet.

**Motivacioni:** *“Për kontribut të shquar në kujdesin shëndetësor në fushën e mjekësisë, për vlerat e larta për mbrojtjen e shëndetit në komunitet dhe shpirtin e paepur të sakrificës, për aftësi të jashtëzakonshme për punën në skuadër, përkushtimin, profesionalizmin dhe humanizmin që e karakterizon në fushën e të drejtave të njeriut”.*

Drejtuesi i komisionit prezantoi projekt-vendimin: Për dhënie titulli “Qytetar Nderi”.  
Hidhet në votë propozimi:

Vota PRO 2

Kundër 0

Abstenim 0

**Miratohet**